

MENYRA E APLIKIMIT DHE LISTA E DOKUMENTEVE

1. Mënyrat e aplikimit për të pajisur një individ me CSP janë, si më poshtë:

- a. Me kërkesë të titullarëve të ministrive dhe institucioneve shtetërore ose personave të autorizuar për punonjësit dhe stafet e tyre, të kontraktuarit ose kategoritë e individëve të parashikuar për të marrë pjesë në një prokurim të klasifikuar;
- b. Me kërkesë të Autoritetit të Sigurimit Kombëtar të një vendi tjetër, anëtar i NATO-s, BE-së ose vend me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje të përbashkët për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar;
- c. Me kërkesë të autoritetit kompetent të sigurisë së NATO-s, të një strukture të saj apo të BE-së;
- ç. Me kërkesë të drejtpërdrejtë të përfaqësuesit ligjor të një operatori ekonomik vendas, në kuadrin e procedurave për pajisje me CSI e CSP, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Lista e dokumenteve që adresohen në DSIK :

- Për mënyrën e aplikimit sipas përcaktimit të bërë në pikën 1 germa “a” (vetëm për punonjësit e institucioneve shtetërore), në DSIK adresohen këto dokumente:
 1. kërkesa e nënshkruar nga titullari, (sipas modelit të miratuar nga DSIK),
 2. pyetësori i sigurisë së aplikantit, i plotësuar në dorëshkrim dhe me germa kapitale, shoqëruar me fotografinë e tij; (sipas modelit të miratuar nga DSIK),
 3. deklaratat për ruajtjen e informacionit të klasifikuar, nënshkruar nga aplikanti; (sipas modelit të miratuar nga DSIK),
 4. deklaratat për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e informacionit dhe kryerjen e verifikimeve, nënshkruar nga aplikanti; (sipas modelit të miratuar nga DSIK),
 5. fotokopje e letër njoftimit (kartës së identitetit) të aplikantit;Modelet e dokumenteve mund t'i shkarkoni nga ky website.
- Për mënyrën e aplikimit sipas përcaktimeve të bërë në pikën 1, gjerat “b”, “c”, “ç” dhe për rastin e të kontraktuarve, ose kategoritë e individëve të parashikuar për të marrë pjesë në një prokurim të klasifikuar nga institucioni shtetëror, në DSIK duhet të adresohen përveç dokumenteve të lartpërmendura, edhe:
 1. dëshmia e penaltetit;
 2. vërtetim nga gjykata;
 3. vërtetim nga prokuroria;
 4. vërtetim nga zyra e përmbartimit.